

Vendim nr. 30 datë 18.04.2024

(V-30/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.04.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (O) 2023, që u përket:

KËRKUES: ODISE XHELITA

SUBJEKT I INTERESUAR:

BANKA E SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga juristët Genci Ndrija dhe Kristi Mezini.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2023-705 (85), datë 07.03.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 11, datë 17.07.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkesit Odise Xhelita, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe një shtetase tjetër, në cilësinë e kredimarrësve, në datën 22.07.2010 kanë lidhur kontratën e kredisë me Bankën Kombëtare Greke, dega Tiranë, në cilësinë e kredidhënësit, për shumën 29.300 euro me afat 25 vjet, me qëllim blerjen e një apartamenti. Në vitin 2011 Banka Kombëtare Greke, dega Tiranë, ka themeluar filialin e ri me emrin Banka NBG, transaksionet e së cilës prej datës 06.06.2018 i kanë kaluar Bankës Amerikane të Investimeve.

2. Në datën 11.09.2013 kërkuesi i është drejtuar Bankës NBG me kërkesë për shlyerjen e parakohshme të kredisë. Me shkresën e datës 18.09.2013, ajo bankë e ka informuar kërkuesin se detyrimi i mbetur deri në këtë datë ishte në vlerën 29.864,16 euro, ku përfshihej principali i mbetur (28.182,48 euro), kësti në vonesë (250,95 euro), penalteti 5 % në rast shlyerjeje përpara kohe (1.409,12 euro) dhe interesi i akumuluar (21,61 euro). Në vijim, kërkuesi ka depozituar shumën 29.864,16 euro në llogarinë bankare të hapur për qëllim të kredisë, duke shlyer kredinë përpara afatit të përcaktuar në kontratë.

3. Kërkuesi i është drejtuar disa herë Bankës NBG për ta informuar zyrtarisht për përfundimin e kontratës së kredisë përpara maturimit dhe reduktimin e kostos totale të saj, duke kërkuar uljen e interesave dhe kostove të aplikuara për pjesën e pashlyer të kredisë, për periudhën e mbetur sipas kontratës; uljen e penalteteve për shlyerjen e parakohshme të kredisë dhe për mosndryshim kolaterali; uljen e shpenzimeve për sigurimin e jetës dhe pronës për periudhën pas shlyerjes së detyrimit. Sipas kërkuesit, nga 25 vjet që ishte afati fillestar, kredia është shlyer në mënyrë të parakohshme në 3 vjet e 2 muaj, ndërkohë që kostot janë paguar referuar periudhës fillestare 25 vjet, përfshirë vlerën e shpërpjestuar të penaltetit prej 5 % për shlyerjen përpara kohe të pjesës së mbetur të kredisë.

4. Për shkak të refuzimit të kërkesës për reduktimin e kostove kërkuesi i është drejtuar Bankës së Shqipërisë me kërkesë për të ndërhyrë nëpërmjet veprimeve korrigjuese ndaj veprimeve në kundërvajtje të Bankës NBG. Banka e Shqipërisë, me shkresën e datës 17.01.2014, ka informuar kërkuesin, ndër të tjera, se, referuar nenit 31 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 9662/2006*), rishikimi i kushteve të kontratës në rastet e shlyerjes së parakohshme të kredisë është e drejtë e bankës tregtare që e ka dhënë atë dhe se kredia për të cilën kishte aplikuar klasifikojë si kredi hipotekare dhe jo konsumatore. Po kështu, sipas përgjigjes së Bankës së Shqipërisë, shpenzimet për sigurimin e jetës dhe të pronës ishin reduktuar, pasi kërkuesit i ishte kthyer

primi i policës së sigurimit në datën 06.12.2013, bazuar në kërkesën e bankës kredidhënëse drejtuar shoqërisë së sigurimit.

5. Në datën 29.01.2014 kërkuesi i është drejtuar Bankës së Shqipërisë me ankesë ndaj shkresës së saj të datës 17.01.2014. Nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që Banka e Shqipërisë të jetë shprehur për këtë ankesë. Ndërsa në datën 12.03.2014 kërkuesi i ka paraqitur Bankës së Shqipërisë kërkesë për pajisje me dokumentacion, konkretisht kopje të vërtetuara të të gjithë praktikës së administruar në lidhje me procedimin administrativ të nisur nga kredimarrësit, duke përfshirë, në veçanti, aktet dhe dokumentacionin e inspektimit të kryer.

6. Në përgjigje të kërkesës për pajisje me dokumentacion, Banka e Shqipërisë, me shkresën e datës 25.03.2014, ka informuar kërkuesin se konkluzionet e procesit mbikëqyrës të ushtruar ndaj Bankës NGB i janë vënë në dispozicion me shkresën e datës 17.01.2014, ndërsa komunikimet mes Bankës së Shqipërisë dhe bankës përkatëse kanë karakter konfidencial dhe nuk mund t'u vihen në dispozicion personave që nuk e gëzojnë këtë të drejtë me ligj.

7. Në këto rrethana, kërkuesi ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit, me objekt detyrimin e Bankës së Shqipërisë që në ushtrim të funksionit të saj të kryejë veprimin administrativ të realizimit të procesit të mbikëqyrjes në lidhje me kontratën e kredisë së tij nëpërmjet kryerjes së inspektimit të plotë të Bankës NGB, konstatimit të veprimeve në kundërvajtje, si dhe të kryerjes së veprimeve korrigjuese, duke marrë masat përkatëse në përfundim të këtij procesi, si dhe detyrimin për ta pajisur me informacionin dhe dokumentet e përdorura në procedurën e mbikëqyrjes.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 11, datë 17.07.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi në datën 18.08.2014, ndërsa në datën 29.09.2014 ka paraqitur kundërrekurs Banka e Shqipërisë. Në datën 31.08.2021 kërkuesi ka paraqitur shtesë rekursi. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1362, datë 16.09.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit.

9. Në datën 11.02.2022 kërkuesi i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë. Gjykata, pas shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 (*vendimi nr. 19/2022*), ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-1362, datë 16.09.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë kolegji. Pas dhënies së këtij vendimi, kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e pjesës hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. 19/2022 të Gjykatës. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 127, datë 10.10.2022, (*vendimi nr. 127/2022*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas rishqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 00-2023-705 (85), datë 07.03.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 11, datë 17.07.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit.

11. Në datën 18.09.2023 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 22.11.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për t'u njohur me të dhënat personale* përmes një *procesi të parregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

12.1. *Të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është përbërë nga gjyqtarë të pacaktuar me short. Gjyqtari që ka zëvendësuar gjyqtarin e dorëhequr është caktuar po ashtu pa short dhe në caktimin e gjyqtarëve pa short ka marrë pjesë këshilltari ligjor, në kundërshtim me detyrat funksionale të tij.

12.2. *Të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi gjyqtari relator në Gjykatën e Lartë ka urdhëruar kryerjen e njoftimeve pa studiuar dosjen gjyqësore. Gjyqtari relator, me pakujdesi të rëndë, ka kryer vetëm njoftim individual postar pa pasur qëllim ta njoftonte realisht kërkuesin. Gjykata e Lartë e ka nisur njoftimin 6 ditë përpara seancës, ndonëse afati ligjor është të paktën 15 ditë. Gjykata e Lartë e ka përshpejtuar shqyrtimin e çështjes për shkaqe të pabazuara dhe për të marrë një vendim të paracaktuar. Për çështjen janë kryer të paktën 20 veprime procedurale në kushtet e mungesës së transparencës dhe të painventarizuara në dosje. Gjykata e Lartë nuk ka paraqitur saktë rrethanat e çështjes, që tregon njëanshmërinë e saj.

12.3. *Parimin e sigurisë juridike, të drejtën për t'u dëgjuar, aksesin në drejtësi dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, në kundërshtim me detyrën e lënë nga Gjykata, nuk e ka shqyrtuar shtesën e rekursit të datës 31.08.2021, ku ishte ngritur pretendimi për gjykatën e paanshme. Gjykata e Lartë ka interpretuar në mënyrë kontradiktore nenet 5, paragrafi i dytë, 120, paragrafi i dytë dhe 478, paragrafi i parë, të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkuesi nuk është

treguar dilijent në paraqitjen e shkaqeve të rekursit, pasi nuk ka referenca konkrete ligjore, në një kohë që edhe veprimet në tërësi të Gjykatës së Lartë tregojnë se ajo nuk është treguar dilijente në shqyrtimin e çështjes së kërkuetit.

12.4. *Standardin e arsytimit të lidhur me të drejtën e pronësisë dhe atë të njohjes me të dhënat personale*, pasi nuk janë të sakta, të plota dhe logjike konstatimet e Gjykatës së Lartë lidhur me objektin e gjykimit për sjelljen kontraktore të bankës së nivelit të dytë, pretendimet e kërkuetit, llojin e kredisë hipotekare në raport me atë konsumatore, kundërvajtjet e bankave të nivelit të dytë dhe garancitë e procedimit administrativ, si dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm. Gjykata e Lartë, në kundërshtim me parimin e disponibilitetit të padisë, i ka dhënë çështjes trajtën e mosmarrëveshjes civile. Konkluzioni i saj në këtë drejtim, jo vetëm bie ndesh haptazi me një vendim tjetër të po asaj gjykate, por nuk përputhet me zgjidhjen e dhënë, pasi, sipas ligjit, gjykimi duhej të ishte pushuar. E drejta e pronës duhet të mbrohet edhe nëpërmjet kontributit me veprime pozitive të Bankës së Shqipërisë. Interpretimi i nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006 nga Gjykata e Lartë bie ndesh me vendimin nr. 19/2022 të Gjykatës. Në kuptim të nenit 35, pika 3, të Kushtetutës, legjislacioni bankar nuk kufizon të drejtën për t'u njohur me çdo të dhënë të mbledhur nga Banka e Shqipërisë rreth kërkuetit.

13. ***Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

13.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi kërkueti nuk ka paraqitur asnjë të dhënë rreth ndarjes së çështjes me short në Gjykatën e Lartë, ndaj nuk mund të pretendojë se nuk është hedhur shorti. Argumenti për caktimin e datës së seancës pa u studiuar dosja është i pasaktë.

13.2. Pretendimi për cenimin e parimit të *gjykatës së pavarur dhe të paanshme* nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë, megjithëse nuk e ka njoftuar kërkuetin me mjete elektronike, e ka njoftuar atë me postë, në njërën nga adresat që ka paraqitur në shkresat e tij. Kërkueti nuk ka pretenduar mosmarrjen e njoftimit të postës, ndaj pretendimi për mosnjoftimin në adresën elektronike është i pabazuar.

13.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike, së drejtës për t'u dëgjuar, aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi

Gjykata e Lartë ka dhënë arsyet se përse shtesa e rekursit nuk është shqyrtuar prej saj. Banka e Shqipërisë ka ushtruar rolin mbikëqyrës duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme ndaj Bankës NBG. Inspektimet e Bankës së Shqipërisë nuk fillojnë me kërkesë të klientëve të bankave, të cilët nuk mund të përcaktojnë llojin, intensitetin dhe mënyrën e ushtrimit të inspektimeve. Një pjesë e pretendimeve janë trajtuar më parë nga Gjykata, ndërsa argumenti lidhur me fjalën diligjencë, pra se në vendimet e gjykatave duhet të ketë vetëm fjalë që i ka fjalori, është i pakuptueshëm.

13.4. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyesimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për t'u njohur me të dhënat personale* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë objektit të padisë trajtën civile, por është kërkuesi që mosmarrëveshjen civile kërkon ta realizojë në rrugë administrative, ndonëse nuk ka dispozitë ligjore që autorizon nxjerrjen e aktit administrativ të pretenduar. Informacionin për proceset mbikëqyrëse Banka e Shqipërisë mund t'ua japë vetëm subjekteve të përcaktuara në nenin 91, pika 2, të ligjit nr. 9662/2006. Pretendimi se Banka e Shqipërisë ka akte të tjera për kërkuesin, përveç atyre që ka paraqitur në cilësinë e provës, përbën një pretendim të ri dhe është i bazuar vetëm në hamendësime.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesat paraprake

14. Kërkuesi, përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, ka paraqitur dy kërkesa procedurale: (i) për shtyrjen e afatit të parashtrimeve; (ii) për mospranimin e prapësimeve të subjektit të interesuar.

15. Në lidhje me afatin e paraqitjes së parashtrimeve, i cili ishte caktuar të përfundonte në datën 26.12.2023, kërkuesi ka parashtruar se ishte e pamundur për t'u respektuar prej tij për shkak të festave zyrtare, si dhe për shkak se i nevojitej marrja e dokumenteve shtesë në Gjykatë. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 27.12.2023, bazuar në nenet 38 dhe 43/b të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë, duke shtyrë afatin deri në datën 31.01.2024.

16. Për sa u takon prapësimeve të subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, kërkuesi ka parashtruar se përfaqësuesit e tij janë caktuar me autorizim nga Guvernatori. Ky i fundit,

sipas kërkesit, nuk ka të drejtë për t'u shprehur për procedurat e kryera nga Këshilli Mbikëqyrës, duke përfshirë edhe veprimet e Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë.

17. Gjykata vëren se nenet 44 dhe 53 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8269/1997*) përcaktojnë rolin dhe kompetencat e Guvernatorit. Sipas tyre, ai është kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe vepron si drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, i ngarkuar për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të saj. Në veçanti, Guvernatorit i njihet kompetenca për përfaqësimin e Bankës së Shqipërisë në procedurat ligjore (shkronja “c”, pika 4, e nenit 53 të ligjit nr. 8269/1997). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se prapësimet e subjektit të interesuar janë paraqitur nga përfaqësues të autorizuar rregullisht, ndaj pretendimi i kërkesit është i pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkesit

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Gjykata vlerëson se kërkesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

21. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

22. Në çështjen konkrete, vendimi i Gjykatës së Lartë që kundërshtohet nga kërkuesi është dhënë në datën 07.03.2023, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 18.09.2023, nëpërmjet shërbimit postar. Gjykata e Lartë në datën 19.05.2023 i ka dërguar kërkuesit vendimin në adresën e postës elektronike të depozituar prej tij.

23. Subjekti i interesuar ka prapësuar se Gjykata duhet të verifikojë ditën se kur vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare, pasi në jurisprudencën kushtetuese është mbajtur qëndrimi se afati ligjor 4-mujor fillon nga kjo ditë. Në mbështetje të këtij prapësimi, subjekti i interesuar ka referuar vendimin nr. 226, datë 01.11.2023 të Kolegjit të Gjykatës, në të cilin afati ishte llogaritur nga dita e publikimit të vendimit në Gjykatën e Lartë. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë prapësim, duke parashtruar se ai është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të jurisprudencës kushtetuese për llogaritjen e fillimit të afatit ligjor.

24. Gjykata ka pohuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit, për qëllime të afatit ligjor 4-mujor, konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrimi për publikimin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës, përveç atij për shpalljen në mjediset fizike të saj, shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individi depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij (*shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa më lart, Gjykata thekson se në rastet kur individi depoziton të dhënat e kontaktit elektronik, njoftimi individual në adresën elektronike është i detyrueshëm dhe ka përparësi në radhë për qëllime të vlerësimit të të drejtave procedurale të individit, përfshirë përlllogaritjen e afateve ligjore. Në këtë kuptim, është e papërshtatshme referenca e subjektit të interesuar në vendimin nr. 226, datë 01.11.2023 të Kolegjit të Gjykatës, në të cilin afati ishte llogaritur nga dita e publikimit të vendimit në Gjykatën e Lartë, pasi në atë rast ankuesi nuk rezultoi të kishte depozituar të dhënat elektronike të kontaktit të tij. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete, momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuesit, nga i cili ka filluar afati ligjor 4-mujor, konsiderohet data 19.05.2023 kur vendimi i është dërguar në adresën e postës elektronike. Për rrjedhojë, kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues brenda afatit ligjor 4-mujor dhe legjitimohet *ratione temporis*.

26. Në drejtim të legjitimitit *ratione materiae* Gjykata fillimisht vëren se në përmbajtje të ankimit, në pjesën e argumenteve të legjitimitit të tij, kërkuesi ka pretenduar se vetë Gjykata, në dhënien e vendimeve nr. 19/2022 të Gjykatës dhe nr. 127/2022 të Kolegjit, i ka cenuar të drejtën për zgjidhje efektive dhe barazisë përpara ligjit, ndaj ai rezervon të drejtën për të ushtruar çdo mjet ligjor kundërshtimi për ato vendime. Sipas kërkuetit, pretendimet e paraqitura më parë prej tij nuk janë zgjidhur në mënyrë efektive, pasi Gjykata nuk ka konstatuar pretendimet për përgjegjësitë që kishte për detyrë të ushtronte Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa vendimi nr. 127/2022 i Kolegjit është marrë në tejkalim të kompetencave, në kushtet e diskriminimit dhe pa u respektuar e drejta për t'u njohur me të dhënat e mbledhura.

27. Në funksion të këtij pretendimi, kërkuesi ka kërkuar që Gjykata të marrë mendimin me shkrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave lidhur me legjislacionin për normat tekniko-profesionale dhe metodologjinë e shërbimit arkivor, duke parashtruar se ai është i nevojshëm për të ndryshuar qëndrimin që Gjykata ka mbajtur në vendimin nr. 19/2022 të saj në rastin e kërkuetit. Konkretisht, në atë vendim Gjykata është shprehur se pretendimi i kërkuetit se Gjykata e Lartë kishte detyrimin të njihte dhe të zbatonte legjislacionin për normat tekniko-profesionale dhe metodologjinë e shërbimit arkivor, nuk është ngritur në nivel kushtetues.

28. Subjekti i interesuar ka prapësuar se, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, vendimet e Gjykatës janë përfundimtare dhe nuk mund të rishikohen, ndaj është i papranueshëm pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës për zgjidhje efektive dhe barazisë përpara ligjit.

29. Gjykata evidenton se, në thelb, pretendimi i kërkuetit lidhet me rishikimin dhe interpretimin e vendimeve të mëparshme të saj. Kushtetuta në nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, shprehet qartësisht në lidhje me forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, edhe në nenet 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 është parashikuar se vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar forca detyruese dhe natyra përfundimtare e vendimeve të Gjykatës. Efekti detyrues i këtyre vendimeve ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të tyre. Nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata (*shih vendimet nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nga ana tjetër, ligji nr. 8577/2000, në nenin 80, pika 1, të tij, ka rregulluar kompetencën e Gjykatës për të saktësuar dhe plotësuar vendimin e saj kur konstatohen gabime

në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi e dukshme, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes. Ndërsa, sipas nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të po këtij ligji, nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës për rihapje të procesit gjyqësor.

31. Mbi bazën standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se pretendimi për zgjidhje efektive dhe barazi përpara ligjit vë në dyshim natyrën përfundimtare të vendimeve të mëparshme të saj, përtej kushteve të parashikuara nga ligji për saktësimin e vendimeve ose rihapjen e procesit. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim dhe kërkesa për marrjen e mendimit me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk pranohet.

32. Në vijim të verifikimit të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor, ndaj i kanë cenuar: (i) të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj; (ii) të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; (iii) parimin e sigurisë juridike, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor; (iv) standardin e arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për t'u njohur me të dhënat personale. Gjykata konstaton se e drejta për t'u njohur me të dhënat personale, e drejta e pronësisë dhe e drejta për proces të rregullt ligjor garantohen nga nenet 35, 41 dhe 42 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë në kompetencën lëndore të saj.

33. Për sa i takon së drejtës për t'u njohur me të dhënat personale dhe së drejtës së pronës, ndonëse ato garantohen veçmas nga nenet 35 dhe 41 të Kushtetutës, kërkuesi pretendimet e tij i ka ngritur ndaj procesit gjyqësor të zhvilluar, ndaj Gjykata çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

34. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, Gjykata vëren se ai është parashtruar nga kërkuesi bazuar vetëm në argumente që lidhen me njëanshmërinë e gjyqtarëve, ndaj do ta shqyrtojë atë në këndvështrim të parimit të gjykatës së paanshme. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, së drejtës për t'u dëgjuar dhe aksesit në gjykatë, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi e ka lidhur atë me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka arsyetuar vendimin e saj, Gjykata çmon ta analizojë në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

35. Për sa më lart, Gjykata do të analizojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve për cenimin e të drejtave për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të paanshme, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

36. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke parashtruar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin në çështjen e kërkuesit është përbërë nga gjyqtarë të pacaktuar me short. Sipas tij edhe gjyqtari që ka zëvendësuar gjyqtarin e dorëhequr është caktuar pa short dhe në caktimin e gjyqtarëve pa short ka marrë pjesë këshilltari ligjor, në kundërshtim me detyrat funksionale të tij.

37. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar. Sipas tij, duke mbajtur në konsideratë pohimin e kërkuesit se nuk ka asnjë të dhënë rreth ndarjes së çështjes me short në Gjykatën e Lartë, në mungesë të të dhënave ai nuk mund të pretendojë se nuk është hedhur shorti.

38. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një prej aspekteve të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këtë të drejtë Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vijim, Gjykata vëren se, në përputhje me këtë të drejtë kushtetuese, nenet 25 dhe 23, pika 6, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 98/2016*) parashikojnë se ndarja e çështjeve gjyqësore dhe zëvendësimi i një gjyqtari në trupin gjykues bëhet me short, i cili realizohet në rrugë elektronike, bazuar në parimet e transparencës dhe të objektivitetit.

39. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se tre gjyqtarët në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkuesit janë caktuar duke u bazuar në vendimin nr. 17, datë 07.07.2022 “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues të secilit kolegji”, të nxjerrë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 23 dhe shkronjës “ç” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016. Në datën 02.02.2023 një prej tre gjyqtarëve ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, dorëheqje e cila është pranuar me vendimin nr. 289/1, datë 02.02.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në vijim, në datën 06.02.2023 është

mbajtur procesverbali në lidhje me formimin e trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes, ku tregohet caktimi i gjyqtarit zëvendësues. Me vendimin e datës 13.02.2023 relatori i çështjes ka caktuar shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në datën 07.03.2023, datë në të cilën është shpallur edhe vendimi i kundërshtuar.

40. Kërkuesi në ankimin kushtetues individual, gjatë parashtrimit të këtij pretendimi, ka kërkuar nga Gjykata marrjen e akteve të inspektimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) për procedurat e shortit në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar se në dosjen e çështjes së tij gjyqësore nuk janë dokumentuar procedurat për caktimin e trupit gjykues dhe plotësimin e tij me një tjetër gjyqtar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Sipas tij, ILD-ja, bazuar në nenin 25, pika 4, të ligjit nr. 98/2016, ka detyrimin të kryejë rregullisht inspektime të ndarjes së çështjeve me short. Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument se përse aktet e inspektimit të ILD-së nuk janë tërhequr për t'u paraqitur prej vetë atij në gjykimin kushtetues në përputhje me nenin 43/b, shkronja "c", të ligjit nr. 8577/2000, dhe as ndonjë argument nëse është penguar për tërheqjen e akteve, në kushtet kur atij i përket barra për të paraqitur provat që mbështesin pretendimet e tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk duhet të pranohet.

41. Në analizë të rrethanave të mësipërme, Gjykata nuk konstaton ndonjë të dhënë që të tregojë mosrespektimin e rregullave procedurale në Gjykatën e Lartë për caktimin e trupit gjykues dhe zëvendësimin e njërit prej anëtarëve, pas paraqitjes së kërkesës për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Ashtu siç prapëson, me të drejtë, subjekti i interesuar, argumentet e kërkuesit janë hipotetike dhe nuk mjaftojnë për të mbështetur pretendimin e tij, pasi, ndonëse pohon se nuk disponon ndonjë të dhënë faktike, ai nxjerr përfundimin për shkeljen e rregullave të shortit. Po kështu, Gjykata rithekson se veprimtaria e këshilltarit ligjor ka natyrë ndihmëse dhe këshillimore për funksionet gjyqësore të trupit gjykues dhe dokumentohet në akte me karakter të brendshëm, të cilat nuk janë të detyrueshme për t'iu komunikuar palëve (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se mënyra dhe cilësia e përmbushjes së detyrave funksionale të këshilltarit ligjor, si rregull, nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues kur Gjykata verifikon pretendimet për procesin e rregullt ligjor.

42. Për sa më lart, në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

C.2. Për cenimin e parimit të gjykatës së paanshme

43. Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtari relator në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë ka urdhëruar kryerjen e njoftimeve pa studiuar dosjen gjyqësore. Sipas tij, gjyqtari relator kishte dijeni për adresën elektronike dhe postare të vlefshme të kërkuesit, por me pakujdesi të rëndë, në formën e neglizhencës, ka kryer vetëm njoftim individual postar pa pasur qëllim ta njoftonte realisht kërkuesin. Po kështu, kërkuesi ka parashtruar se njoftimi me fletëthirrje për kohën e seancës është i pavlefshëm, pasi Gjykata e Lartë e ka nisur njoftimin 6 ditë përpara seancës, ndonëse afati ligjor është të paktën 15 ditë. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka përshpejtuar shqyrtimin e çështjes për shkaqe të pabazuara dhe për të marrë një vendim të paracaktuar. Po sipas tij, për çështjen janë kryer të paktën 20 veprime procedurale në kushtet e mungesës së transparencës, të painventarizuara në dosje dhe Gjykata e Lartë nuk ka paraqitur saktë rrethanat e çështjes, që tregojnë njëanshmërinë e saj.

44. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së paanshme është i pabazuar, duke parashtruar se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje çështjeve të trajtuara nga Gjykata në vendimin që ka urdhëruar rishqyrtimin e çështjes. Sipas tij, Gjykata e Lartë e ka njoftuar kërkuesin me postë, në njërën nga adresat që ka paraqitur në shkresat e tij dhe jo me *e-mail*. Po sipas subjektit të interesuar, duke qenë se kërkuesi nuk pretendon që nuk e ka marrë njoftimin e postës, nuk qëndron argumenti për mosdërgimin me *e-mail* të njoftimit.

45. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por edhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 46, datë 19.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në çështjen konkrete Gjykata konstaton se, për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve, përfshirë atë të gjyqtarit relator, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë thelbësore, por e ka bazuar këtë pretendim në interpretimin e veprimeve procedurale të çështjes, të cilat analizohen në vijim.

47. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të dytë ka nënshkruar deklaratën për t'u njoftuar edhe në adresën e postës elektronike, megjithatë kjo adresë nuk është përdorur nga Gjykata e Lartë. Në datën 13.02.2023 sekretaria e Gjykatës së

Lartë ka realizuar shpalljen publike të njoftimit për seancën e datës 07.03.2023, ora 13:00, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues. Gjithashtu, përpara rishqyrtimit të çështjes së tij në Gjykatën e Lartë, sekretaria gjyqësore ka lëshuar dy herë akte njoftimi drejtuar kërkuesit individualisht në adresat fizike: (i) në datën 13.02.2023 dhe dëftesa e komunikimit mban shënimin “zyra mbyllur”; (ii) në datën 28.02.2023 dhe dëftesa e komunikimit është nënshkruar dhe mban shënimin “mora dijani”, por me emër të pakuptueshëm. Njoftimi i dytë është nisur në adresën e shënuar nga kërkuesi në aktet e apelit dhe të rekursit, ndërsa në aktin e shtesës së rekursit ai ka caktuar një adresë të re, e cila nuk rezulton të jetë përdorur nga Gjykata e Lartë. Pas marrjes së njoftimit për datën e seancës nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur parashtrime në Gjykatën e Lartë dhe as ndonjë pretendim për vlefshmërinë e njoftimeve.

48. Në analizën e këtyre të dhënave, Gjykata vë në dukje se kërkuesi nuk mohon të ketë marrë dijani për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Pretendimi i tij lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si është realizuar njoftimi, duke theksuar mungesën e njoftimit elektronik, që, sipas tij, përbën tregues të njëanshmërisë së gjyqtarit relator. Në këto rrethana, Gjykata çmon se argumenti i kërkuesit se gjyqtari relator e ka dërguar njoftimin e kërkuesit në adresa të pavlefshme, ndonëse kishte dijani për adresat e sakta elektronike dhe postare, është i pamjaftueshëm për të provuar qëndrimin subjektiv të njëanshëm të gjyqtarit, në kushtet kur aktet e njoftimit të palëve përpilohen dhe dërgohen nga sekretaria gjyqësore, ndërsa gjyqtari ka detyrën të verifikojë dhe mbikëqyrë realizimin e tyre. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se saktësia e veprimeve të administratës gjyqësore në kryerjen e njoftimeve paraqet rëndësi thelbësore në drejtim të efektivitetit të gjykimit, ndërsa lidhur me elementet e procesit të rregullt ligjor ajo merr vlerë përcaktuese kur nuk është riparuar nga gjyqtari përgjegjës dhe eventualisht i ka sjellë pasojë reale individit në ushtrimin e të drejtave kushtetuese. Për sa i takon dërgimit të njoftimit 6 ditë përpara seancës gjyqësore dhe jo 15 ditë, sikur parashikon pika 5 e nenit 460 të KPC-së, Gjykata ripohon se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjithashtu, Gjykata çmon se periudha e shkurtër e rishqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përbën argument që të provojë pretendimin për cenimin e paanshmërisë në kuptimin subjektiv. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje pas rikthimit të çështjes nga Gjykata dhe bazuar në vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky fakt përbën shkak për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

50. Për sa i përket paanshmërisë objektive, Gjykata vëren se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve të çështjes. Argumentet e kërkuetit për cenimin e këtij parimi nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur njëanshmëri të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, pasi ai nuk ka paraqitur ndonjë provë konkrete për të mbështetur këtë pretendim.

51. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkueti nuk ka arritur të argumentojë cenimin e parimit të paanshmërisë në aspektin subjektiv ose objektiv të tij, për rrjedhojë edhe ky pretendim është i pabazuar.

C.3. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

52. Kërkueti ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është dhënë në kundërshtim me ligjin dhe se mospranimi për shqyrtimin e shtesës së rekursit nga Gjykata e Lartë, për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor, është rezultat i interpretimit kontradiktor të neneve 5, paragrafi i dytë, 120, paragrafi i dytë dhe 478, paragrafi i parë, të KPC-së. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk është shprehur nëse Banka e Shqipërisë ka ushtruar në mënyrë të ligjshme pushtetin diskrecional dhe as për zbatimin e nenit 75 të ligjit nr. 8269/1997 të lidhur me vendimin nr. 52/2002 (manuali i veprimeve korrigjuese ndaj bankave). Kërkueti ka parashtruar se arsytimi i Gjykatës së Lartë është jologjik, pasi e ka trajtuar objektin e padisë sipas së drejtës civile. Po kështu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar detyrat e lëna nga Gjykata në vendimin nr. 19/2022, pasi nuk ka shqyrtuar pretendimin për cenimin e gjykatës së caktuar me ligj gjatë gjykimit në shkallë të dytë dhe nuk ka interpretuar nenin 91 të ligjit nr. 9662/2006, në kushtet kur neni 35 i Kushtetutës dhe legjislacioni bankar nuk kufizojnë të drejtën e kërkuetit për t'u njohur me çdo të dhënë të mbledhur nga Banka e Shqipërisë rreth tij. Gjithashtu, kërkueti pretendon se Gjykata e Lartë ka përdorur termin "diligjencë", që nuk e njeh ligji procedural dhe as Fjalori i Gjuhës Shqipe, por edhe nëse i jepet kuptim kësaj fjale, është vetë Gjykata e Lartë që nuk është treguar diligjente në shqyrtimin e çështjes së tij.

53. Subjekti i interesuar ka prapësuar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë objektit të padisë trajtën civile, por është kërkueti që një mosmarrëveshje të natyrës civile kërkon ta realizojë në rrugë administrative pa pasur dispozitë ligjore. Sipas tij, kërkueti nuk paraqet ndonjë referencë ligjore për të drejtën e marrjes dijeni të proceseve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë, informacioni i cili u jepet vetëm subjekteve të përcaktuara në nenin 91, pika 2, të ligjit nr. 9662/2006. Banka e Shqipërisë ka ushtruar rolin e saj të mbikëqyrjes duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme ndaj Bankës NBG. Po kështu, subjekti i interesuar ka prapësuar

se Gjykata e Lartë ka dhënë argumentet e saj për mospranimin e shkaqeve të shtesës së rekursit të kërkuesit, ndërsa pretendimi për përdorimin e fjalës “diligjencë” është i pakuptueshëm.

54. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se kur pretendimi lidhet me mënyrën e interpretimit të ligjit, ajo ndërhyt vetëm kur interpretimi është arbitrar ose kur konstaton gabim ligjor aq evident që të karakterizohet si një gabim që asnjë gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose të jetë i tillë që të prishë drejtësinë e procesit (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Gjykata në vijimësi ka pohuar se ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimet nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 18, datë 14.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se me vendimin nr. 19/2022, me të cilin është pranuar ankimi kushtetues individual i kërkuesit, ajo ka vlerësuar se në respektim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata e Lartë në rishqyrtimin e çështjes duhet të: (i) evidentojë në vendimin e saj shkaqet e parashtruara në shtesën e rekursit, edhe nëse në përfundim do të konkludojë se shtesa është paraqitur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ndërsa nëse e vlerëson të ligjshme paraqitjen e shtesës, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si rrjedhojë e shortimit manual të trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, duhet të gjejë pasqyrim dhe t’i jepet përgjigje si pretendim i natyrës kushtetuese (*shih paragrafin 43 të vendimit nr. 19/2022*); (ii) arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, pretendimin lidhur me zbatimin e nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006 që lidhet me të drejtën e kërkuesit për informim dhe njohjen me të dhënat e mbledhura rreth tij (*shih po aty, paragrafët 46-47*).

57. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë, pas rishqyrtimit të çështjes, në vendimin nr. 00-2023-705 (85), datë 07.03.2023, ka pasqyruar në pjesën hyrëse, në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e paraqitura në shtesën e rekursit. Lidhur me këto të fundit ka arsyetuar se bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka konkluduar se në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit të datës 31.08.2021 nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme (*shih paragrafët 21, 22 dhe 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

58. Për sa i takon së drejtës për informim, Gjykata e Lartë ka analizuar kuadrin rregullator ligjor dhe nënligjor për kompetencat e Bankës së Shqipërisë, si dhe përmbajtjen e shkresës së datës 17.01.2014 të atij institucioni drejtuar kërkuesit. Ajo ka arsyetuar se “llogaridhënia” e Bankës së Shqipërisë në raport me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse është çështje e kontrollit gjyqësor sipas nenit 72 të ligjit nr. 8269/1997 dhe se ligji nuk ka parashikuar funksionimin e ndonjë organi kompetent në Bankën e Shqipërisë ose ndonjë procedurë konkrete për të shqyrtuar ankimet e konsumatorëve për mosmarrëveshjet me bankat e nivelit të dytë (*shih paragrafët 30 dhe 31 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesi është njohur me rezultatin e procedurës mbikëqyrëse dhe me aktet, si dhe pretendimet e tij që banka tregtare nuk ka zbatuar në mënyrën e duhur aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, janë çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të kontratës së kredisë, për rrjedhojë ato duhet të ishin adresuar gjyqësisht në një gjykim të një natyre tjetër (*shih paragrafët 33 dhe 34 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

59. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 00-2023-705 (85), datë 07.03.2023 i Gjykatës së Lartë i ka dhënë përgjigje të shprehur kërkuesit se pretendimi i parashtruar në shtesën e rekursit është i papranueshëm, duke interpretuar ligjin procedural. Interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë nuk rezulton të jetë arbitrar dhe as me gabime ligjore evidente, që të kenë prishur drejtësinë e procesit. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka interpretuar ligjin, brenda kompetencave kushtetuese të saj, si gjykatë ligji dhe interpretimi konkret nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se nuk qëndron pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar ligjin procedural kur ka vlerësuar papranueshmërinë e shtesës së rekursit.

60. Po kështu, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka përmbushur standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor, siç ato janë evidentuar në vendimin nr. 19/2022. Ajo ka pasqyruar në vendimin e saj shkaqet e parashtruara në shtesën e rekursit, si dhe ka arsyetuar përse kjo shtesë

rekursi nuk mund të merrej në shqyrtim. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin e kërkuarit në themelin e tij dhe ka arsyetuar edhe të drejtën për informim të tij, në raport me legjislacionin bankar, përfshirë nenin 91 të ligjit nr. 9662/2006. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se forca detyruese e vendimit të saj nr. 19/2022 nuk është vënë në dyshim nga Gjykata e Lartë.

61. Për sa i takon paqartësisë së konceptit “diligjent”, që është përdorur në vendimin e Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se koncepti nuk ka krijuar paqartësi të nivelit kushtetues. Koncepti i dilijencës i referohet një huazimi, që, siç ka evidentuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në thelb përmban kërkesën që palët duhet të tregohen të kujdesshme në respektimin e hapave proceduralë për çështjen e tyre (*shih Bąkowska kundër Polonisë, datë 22.11.2010, § 54*).

62. Nga ana tjetër, vetë kërkuari duket që e ka kuptuar këtë fjalë të huazuar, sepse ka parashtruar në ankim pretendimin se vetë Gjykata e Lartë nuk është treguar dilijente në shqyrtimin e çështjes së tij. Lidhur me këtë pretendim të fundit, Gjykata, në shtesë të analizës së veprimtarisë procedurale të Gjykatës së Lartë, në kuadër të pretendimeve për gjykatën e caktuar me ligj dhe të paanshme, rithekson se nga shqyrtimi i vendimit të saj nuk rezultojnë gabime në interpretimin e ligjit që të nxirret përfundimi që ai të ketë qenë arbitrar, ndaj ky pretendim është i pabazuar.

63. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë është i pabazuar.

64. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit ndaj procesit gjyqësor të zhvilluar janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj nuk rezulton që të jenë cenuar e drejta e pronës dhe e drejta për t’u njohur me të dhënat personale, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual i kërkuarit rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.04.2024

Shpallur më 16.05.2024